

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“RADEON SECURITY GUARD” SHPK

Themeluesi që nënshkruan më poshtë:

- **Shoqëria Tregtare “RADEON IMPORT EXPORT” SHPK**, shoqëri e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Nr. NUIS/NIPT-i L62612202M, me seli në adresën: Lagjja “Luigj Gurakuqi”, Bulevardi “Aqif Pasha”, Hotel Skampa, kati 2, Zona Kadastrale Nr. 8521, Pasuria Nr. 1/66, Elbasan, përfaqësuar sipas Vendimit të datës 09.09.2020 të Asamblesë së Përgjithshme/Ortakut të Vetëm të kësaj shoqërie nga znj. Alma ÇIFTJA, e bija e Gëzim, e datëlindjes 04.04.1986, lindur në Elbasan dhe banuese në Elbasan në adresën: Lagja “28 Nëntori”, Rruga “Tasim Çiftja” Elbasan, mbajtëse e pasaportës me Nr. BJ7526859 dhe Nr. Identifikimi Personal: I65404132H, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Sot më datë 09.09.2020, bazuar në vullnetin e tij të lirë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” (i ndryshuar) si dhe Ligjin Nr. 75/2014 datë 10.07.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, vendosi të themelojë Shoqërinë Tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në bazë të kushteve që vijojnë:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, RREGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i veprimtarisë.

Shoqëria tregtare “RADEON SECURITY GUARD” SHPK ka si objekt te veprimtarisë se saj:

- a) Ofrimin e shërbimit të sigurimit dhe ruajtjen fizike të objekteve shtetërore dhe/ose private, të personave të ndryshëm civile dhe/ose juridikë, si të veprimtarive social-kulturore sportive, fetare e politike;
- b) Ofrimin e shërbimit të sigurimit dhe/ose shoqërimit të vlerave monetare, materiale dhe të sendeve të çmuara gjatë transportit.

Neni 2. Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë

2.1. Ortaku i Vetëm vendosi që shoqërinë ta emërtojë: “RADEON SECURITY GUARD” SHPK dhe të mbajë emrin tregtar “R.S.G.” SHPK;

2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Administrative Brandashesh, Rruga Elbasan-Metalurgjik km.5, Zona Kadastrale 3965, Pasuria nr. 938, brenda ish "Kombinatit Metalurgjik", Elbasan.

2.3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete, bashki apo njësi administrative të tjera të Republikës Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3. Regjimi juridik

3.1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

3.2. Me vendim të tij, Ortaku i Vetëm mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm do të përshtatë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.

3.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4 . Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve/Ortakut

4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqëria ka të drejtë të marre pjesë si ortak në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.

4.5. Ortaket/Ortaku merr pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

4.6. Ortakët/Ortaku kanë/ka të drejtë të marrin/marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5. Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme/Ortakut të Vetëm, sipas dispozitave të Statutit të Shoqërisë.

Kreu III KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Shoqëria tregtare “RADEON SECURITY GUARD” SHPK do të fillojë veprimtarinë e saj me një kapital themeltar prej 4.000.000,00 (katër milionë) Lekë, e cila zotërohet tërësisht nga ortakët.

6.2. Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë është :

- Shoqëria Tregtare “RADEON IMPORT EXPORT” SHPK, 1 (një) kuotë në vlerën 4.000.000,00 (katër milionë) Lekë e cila përbën dhe përkatësisht 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

6.3. Transferimi i kuotës së në tërësi, ose të një pjese të saj pas pjesëtimit të saj sipas nenit 75 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) nuk mund të realizohet nën vlerën nominale të saj. Vlera nominale e kuotës e zotëruar nga ortaku i vetëm është e përcaktuar si më sipër (pika 6.2 e këtij neni). Vlera nominale e kuotës pas pjesëtimit përcaktohet në aktin e pjesëtimit.

Kreu IV ORGANET E SHOQERISË

Neni 7

7.1. Vendimet në Shoqëri merren nga Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm e shoqërisë. Këto vendime shënohen në regjistrin përkatës. Administratori i Shoqërisë dhe eventualisht audituesi ligjor caktohet nga Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm.

7.2 Asambleja e Përgjithshme ka vendosur që administratori i parë i shoqërisë të jetë Z. Xhevahir QOSJA, i biri i Sabri, i datëlindjes 07.03.1962, lindur në Mollas/Elbasan dhe banues në Elbasan, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 035276581 dhe Nr. Identifikimi Personal G20307071R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili do të ushtrojë detyrat me një mandat 5 (pesë) vjeçar.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 8

8.1 Administrimi i Shoqërisë do te behet ne përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.

Kreu VI DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

9.1. Fitimi i realizuar nga Shoqëria, mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet ortakëve të shoqërisë në përputhje me pjesët e tyre takuese.

9.2. Ky Akt shtypet dhe firmoset ne 6 (gjashtë) kopje, te gjitha me te njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron ne dokumentacionin bazë te Shoqërisë.

9.3 Asambleja e Përgjithshme ka vendosur që Drejtuesi Teknik i shoqërisë të jetë Z. Xhevahir QOSJA, i biri i Sabri, i datëlindjes 07.03.1962, lindur në Mollas/Elbasan dhe banues në Elbasan, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 035276581 dhe Nr. Identifikimi Personal G20307071R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

9.3 Autorizohet administratori, z. Xhevahir QOSJA, të ndjekë procedurat e duhura për regjistrimin e kësaj shoqërie pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Për realizimin e saj, ai ka të drejtë të emërojë apo caktojë dhe persona të tjerë.

THEMELUESI

“RADEON IMPORT EXPORT” SHPK

Përfaqësuar nga
Znj. Alma ÇIFTJA

